



Seria "imageRUNNER ADVANCE DX C3800"

LIDHJE TË SIGURTA, TRANSFORMIM DIGJITAL

PERFORMANCË OPTIMALE DHE PRAKTICITET I PAKRAHASUESHËM NGA TEKNOLOGJI NOVATORE

E ardhmja e biznesit është dixhitale. "Canon imageRUNNER ADVANCE DX" është një gjeneratë e re pajisjesh inteligjente shumëfunktionale, projektuar për të mbështetur dhe përshpejtuar çdo hap të transformimit tuaj dixhital. Krijuar me "Canon imageRUNNER ADVANCE DNA", softuerët dhe teknologjia e fjalës së fundit shkojnë krah për krah në dixhitalizimin, automatizimin dhe optimizimin e proceseve të punës të orientuara drejt përmbajtSjeve. Si gjithnjë ne e zhvillojmë vazhdimisht teknologjinë tonë për t'ju bërë të ndiheni të sigurt dhe konfidentë kur përdorni pajisjet e Canon.

Seria Canon imageRUNNER ADVANCE DX C3800 ofron siguri të përmirësuar dhe servis të thjeshtuar, me cikle inteligjente pune me dokumentet dhe cilësi vibrante të figurës. Ideale për zyrat e vogla deri të mesme dhe kompanitë e mëdha që kërkojnë një pajisje MFP fleksibël dhe efikase, këto pajisje të qeta dhe të qëndrueshme integrohen më së miri me ambientet hibride të punës. uniFLOW Online Express vjen si standard, duke ofruar menaxhim të centralizuar të pajisjeve dhe bashkëpunim të sigurt në renë kompjuterike.



**LIDHJE NË RENË
KOMPJUTERIKE**



SIGURI



PRODUKTIVITET



QËNDRUESHMËRI



MUNDËSI SERVIISI

Canon

Seria "imageRUNNER ADVANCE DX C3800"



LIDHJE NË RENË KOMPJUTERIKE

- Softueri standard me bazë reje kompjuterike uniFLOW Online Express (uFOE) ofron një zgjidhje të vetme të integruar për të rritur sigurinë e pajisjes dhe për të thjeshtuar menaxhimin e printimeve
- Skanoni dhe printoni në mënyrë të sigurt dokumentet nga kudo, me lidhje të përmirësuara në renë kompjuterike
- Formatet e ripërdorshme të printimit lejojnë akses të lehtë të dokumentet në renë kompjuterike
- Platforma MEAP e "Canon" optimizon proceset duke u integruar me zgjidhje menaxhimi të regjistrimit dhe produktiviteteve, si p.sh. uniFLOW Online
- Pajisja i ofron vetë aplikacionet si AirPrint, Mopria, Universal Print by Microsoft dhe Canon PRINT Business app



SIGURI

- Verifikimi i sistemit në nisje, mbështetja për SIEM dhe McAfee Embedded Control e analizojnë pajisjen në kohë reale për të zbuluar dhe parandaluar sulmet e jashtme
- TPM 2.0 (Trusted Platform Module) vjen si standard dhe ruan në mënyrë të sigurt çelësat e enkriptimit, si p.sh. fjalëkalimet
- Konfiguroni autentifikimin e pajisjeve, autentifikimin me dy elemente dhe kufizimet e funksioneve të pajisjeve, si për masat e sigurisë në pajisje, ashtu edhe me bazë reje kompjuterike
- Njësia e enkriptuar SSD zgjeron mbrojtjen e të dhënave dhe është më rezistente ndaj dridhjeve dhe goditjeve për më shumë qëndrueshmëri



PRODUKTIVITET

- Printoni dhe skanoni deri në 35 ppm dhe 270 ipm
- Arkivijoni automatikisht dokumentet me Filing Assist me bazë reje kompjuterike nga uniFLOW Online*
- Largoni shqetësimet për funksionimin fizik të pajisjes, pa cenuar praktikitetin për përdoruesin, duke vendosur** shtresë opsionale antimikrobiale mbi të gjitha pikat e zakonshme të prekjës
- Digjitalizojini dokumentet me efikasitet me cikle pune me një prekje dhe butona shkurtores në ekranin Bazë
- Aktivizoni punën fleksibël hibride dhe minimizoni bashkëveprimin me pajisjen falë eksperiencës së vazhdueshme të përdoruesit përmes Canon PRINT Business app
- Përmirësoni produktivitetin me kapjen e deri në 50 fletëve me aksesorin opsional Instant Stapler – mjaftueshëm i vogël për t'u mbajtur mbi pajisje apo tryeza, kudoqoftë në zyrë, shtëpi apo ambientet e përbashkëta të punës



QËNDRUESHMËRI

- Zhurma e reduktuar e punës nga izolimi akustik i pjesës së jashtme të MFP siguron punë të qetë dhe parandalon shqetësimet në ambientet e përbashkëta të punës
- Modaliteti Eco Recovery ul konsumin e energjisë për të kursyer energji dhe për të ulur kostot operative
- Skanim i cilësisë së lartë pa gabime, duke përfshirë drejtimin digital të figurës dhe xhamin e avancuar rezistent ndaj njollave që ul firot
- Kapëset ekonomike reduktojnë kostot e kapësive dhe kontribuojnë drejt një prodhimi e menaxhimi më ekologjik të dokumenteve



MUNDËSI SERVISI

- Kurseni kosto dhe rrisni kohën e përdorimit të pajisjes me përmirësime inovatore në pjesët fizike që zëvendësohen më shpesh, si pjesë e katalogut tonë në zhvillim imageRUNNER ADVANCE DX
- Parashikimi i jetëgjatësisë së pjesëve të konsumit mundëson ndërrimin sistematik të pjesëve për të ulur kostot e shërbimit
- Përdoruesit mund t'i zëvendësojnë me lehtësi pjesët e konsumit, shpejt, saktë dhe me siguri për të reduktuar vizitat e teknikëve

* "uniFLOW Online" ofrohet si abonim me bazë reje kompjuterike për nxjerrje dokumentesh dhe administrim të regjistrimeve. Sipas nevojave të biznesit, përdoruesit mund të kalojnë në "uniFLOW Online" për të shkuar në larmi përfitimesh të avancuara, mes të cilave: Siguri më të lartë me mënyra autentikimi të përdoruesve. Procese të personalizuar pune për përmirësimin e produktivitetit. Mbetje më të pakta duke i anuluar punët që në pajisje. Një panel intuitiv në renë kompjuterike për të shfrytëzuar të dhëna në kohë reale. Kontroll më i madh mbi aksesin dhe përdorimin, për të reduktuar kostot e printimit.

** rekomandohet që shtresa të vendoset nga një teknik i servisit.

SHËNIM - Karakteristika të caktuara aktivizohen vetëm me kombinimin e imageRUNNER ADVANCE DX dhe të uniFLOW Online

FAKTE TË SHPEJTA



- **Formati:** A3 me ngjyra
- **Kapaciteti i mbushjes me letër (maks.):** 2.300 fletë
- **Koha e nxehtës:** 4 sekonda e poshtë (Quick Startup Mode)
- **Kapacitetet e finicionit:** ngjitje, grupim, ofset, kapje, tegel, shpim, kapje ekologjike, kapje sipas kërkesës
- **Llojet e skedarëve të mbështetur:** PDF, EPS, TIFF/JPEG dhe XPS




- **Shpejtësia e printimit:** 22 - 35 ppm
- **Shpejtësia e skanimit:** 270 ipm (A4)



- **Gjuhët e printimit:** UFR II, PCL6, Adobe® PostScript®3™
- **Rezolucioni i printimit:** 1,200 x1,200

- Produktiviteti i lartë mundësohet me shpejtësi printimi të fjalës së fundit dhe teknologji inovatore të skanimit duke përfshirë një shpejtësi të re printimi prej 35 ppm.
- Softueri i resë kompjuterike uniFLOW Online Express ndihmon në ruajtjen e produktivitetit të vazhdueshëm në të gjithë punën hibride.
- Punoni në mënyrë të sigurt dhe komode në ambiente hibride me funksione të pajisjes si p.sh. kronologji të personalizuar për përdoruesit dhe shtresë mbrojtëse antimikrobiale (opsionale), si dhe printim nga pajisje portative dhe skanim nga aplikacione si Canon PRINT Business app.
- McAfee Embedded Control, TPM 2.0 dhe mbështetja për SIEM mbrojnë dokumentet, rrjetin dhe pajisjen.
- Kapacitetet e përmirësuara të finicionit dhe mbështetja për më shumë lloje letre përmirësojnë cilësinë e prodhimit.
- Mirëmbajtja dhe servisi i lehtë sigurojnë qëndrueshmërinë dhe maksimizojnë kohën operative.
- Digjitalizojini dokumentet me efikasitet përmes cikleve të automatizuara të punës në lidhje me aplikacione si OneDrive, SharePoint, Concur, DropBox dhe Microsoft Teams (nevojitet uniFLOW Online™).
- Zvogëloni ndikimin në mjedis dhe shqetësimet në ambientin e punës me printim dhe skanim më të qetë.

ZGJIDHJE ME POROSI PËR T'I BËRË BALLË ÇDO SFIDE



Shërbimet e Transformimit Digjital (DTS) të Canon, bashkojnë harduerin dhe softuerin tonë kryesor në një ekosistem të teknologjisë së integruar, të krijuar për të mbështetur rrugëtimin tuaj të transformimit. Kjo ofertë kombinon zgjidhjet e Shërbimeve të Menaxhuara të Printimit dhe Bashkëpunimit të Hapësirës së Punës, për t'ju ndihmuar të fitoni transparencë dhe kontroll mbi të gjithë ciklin jetik të dokumenteve.

Canon Inc.
canon.com

Canon Europe
canon-europe.com

Albanian edition
© Canon Europa N.V., 2021

